



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.996/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “H...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1286/19, të datës 21.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Miratohet si bazuar ankesa e paditësit “H...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1286/19, i datës 21.02.2021, anulohet, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit-subjektit, “H...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, ka lënë në fuqi aktvendimin nr. 06.2/476-2016 të datës 15.03.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit “H...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, Anulohet në tërësi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit Administrativ/Divizioni Fiskal A.nr.1286/19 i datës 21.01.2021 sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Doganës së Kosovës nr.06.2/476-2016 i datës 15.03.2019 dhe të obligohet Dogana e Kosovës që subjektit t’i kthehen mjetet monetare të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të mallit gjatë procedurës së zhdoganimit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin, e organit të paditur Dogana e Kosovës, nr.06.2/476-2016 të datës 15.03.2019, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë “H...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e Deklaratës Unike Doganore R-13579/31.05.2016 me të cilat vendime i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore në Prizren, si e pabazuar.

Kundër aktvendimit të cekur të paditurës, subjekti tani paditësi, me padi fillon konfliktin Administrativ në procedurë gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në praninë të përfaqësuesit të palës së paditur, dhe administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, të datës 21.01.2021, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të cekur si më lartë, sipas konkludimeve në arsyetim se; Gjykata nuk ka mundur të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shituar për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Edhe pse pala paditëse para gjykatës ka prezantuar prova materiale si faturën e mallit doganor, faturën e shpenzimeve të transportit, transferin bankar, mirëpo nga të dhënat që posedon fatura përcjellëse e mallit pa numër dhe datë nuk mund të vërtetohet se është paguar vlera e transaksionit në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109. Nga një mosharmonizim i tillë i dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor ku gjykata nuk ka mundur të sigurojë informata të mjaftueshme se është bërë transferi bankar pikërisht për faturën përcjellëse të mallit. Gjykata pranon konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues se ky dokumentacion i mallit i prezantuar nga paditësi nuk është provë e mjaftueshme për tu dëshmuar se është paguar vlera e transaksionit, apo se paditësi ka paraqitur dokumentacionin e duhur e sipas të cilit do të duhej që e paditura Dogana e Kosovës të vlerësonte mallin në bazë të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht sipas vlerës së transaksionit.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet*

e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka pranuar si pagesë të vlefshme transaksionin bankar, pasi që me urdhërpagesën e datës 21.06.2016 të prezantuar nga ana e paditësit, shihet se paditësi ka paguar çmimin sipas faturës përcjellëse të mallit lëndor kontestues nr.DX2016040203 datë 08.04.2016 në shumë prej 35,501.00€ e cila vlerë përputhet me dokumentet tjera përcjellëse të mallit, ndërsa pretendimi i të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pa mjaftueshëm pasi që mungon deklarata eksportuese e shtetit eksportues, nuk qëndron pasi që deklarata eksportuese nuk është dokument i cili kërkohet sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe nuk është dokument i obligueshëm, ndërsa gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka konstatuar se ka mos harmonizim mes dokumenteve përcjellëse të mallit dhe nuk ka mundur të siguroj informata të mjaftueshme se transferi bankar është bërë pikërisht për faturën përcjellëse të mallit pasi që fatura përcjellëse e mallit është pa numër dhe pa datë, Dhoma e Shkallës së Dytë ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka gjetur se fatura e mallit lëndor ndër të tjera përmban edhe numrin DX2016040203 dhe datë 08.04.2016, të dhëna këto që janë shënuar edhe në përshkrimin e transferit bankarë të datës 21.06.2016 në vlerë prej 35,501.00€. Andaj mbi këtë bazë e paditura ka aplikuar në mënyrë të gabuar nenin 35 përkatësisht metodën e 6 të vlerësimit sipas KDA-së, pasi që paditësi ka poseduar të gjitha dokumentet e transaksionit të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe se nga e paditura nuk është prezantuar asnjë provë e cila do të dëshmonte se paditësi ka paguar më shumë se fatura në emër të mallit.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues me nr.06.2/476-2016 i datës 15.03.2019, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë, duhet t'i shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i qartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, t'i vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të kontestuar. Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë, duhet t'i mënjanoj të metat e cekura me lartë, duke vepruar sipas rregullave procedurale kontestimore, t'i vërtetoj faktet relevante dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në ankesë, të vlerësoj dhe analizoj të gjitha provat e nevojshme konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, të aplikueshëm sipas

nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që janë me rëndësi për vendosjen e rastit konkret. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe mënjanimit të shkeljeve esenciale të lartpërmendura, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.996/22, me datë 26.01.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami